

Guvernatori Baker njoftoi se shkollat publike do të qëndrojnë të mbyllura deri në fund të vitit shkollor. Dita e fundit e shkollës për Shkollat Publike të Worcester është 12 qershor, 2020. Guvernatori e ndau këtë si një hap të domosdoshëm për t'i mbajtur të gjithë sa më shëndetshëm që të jetë e mundur. Unë e kuptoj se ky njoftim mund të rezultojë në një varg emocionesh midis stafit, nxënësve dhe familjeve tona. Stafi i Shkollave Publike Worcester do të vazhdojë të ndihmojë nxënësit tanë dhe familjet e tyre përmes mënyrave të shumëfishta, siç janë bisedat telefonike, bisedat në Google (Google chats), bisedave në Zoom dhe Google voice. Mësimi në distancë është edhe më i rëndësishëm tani, dhe ne do të lëshojmë udhëzime shtesë për nxënësit dhe familjet në vazhdim të kësaj jave.

Stafi i Distriktit të Shkollave Publike Worcester do të punojë gjatë dy javëve të ardhshme me drejtorët dhe stafin e shkollave të mesme (high schools) për të adresuar interesat e maturantëve si diplomimi, pranimet në kolegji, bursat dhe notat përfundimtare. Ne do të vazhdojmë t'ju mbajmë të përditësuar.